



**Prishtinë, 23.06.2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1265\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084) - Neni 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1,
- Dispozitat e Rregullave të Tregut, Neni 16.8,
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për aprovim të ndryshimit të koeficienteve të humbjeve të OSSH të datës 28.05.2020,

**në seancën e mbajtur me datë 23.06.2020, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** kërkesa e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për ndryshim të koeficienteve të humbjeve të OSSH.

### **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 28.05.2020 ka pranuar kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për aprovim të ndryshimit të koeficienteve të humbjeve të OSSH.
- ZRRE, bazuar në nenin 16.8 të Rregullave të Tregut, dërgon te palët koeficientet për llogaritjen e humbjeve në shpërndarje. Këta koeficientë shfrytëzohen nga OSSH për blerjen e energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve, dhe nominimin e sajë në baza orë për orë. Meqenëse këta koeficientë merren nga bilanci vjetor i energjisë elektrike i aprovuar nga ZRRE, ndërsa përgatitja e bilancit fillon shumë më herët se fillimi i realizimit të parashikimeve, atëherë saktësia e koeficienteve zvogëlohet dhe kjo ndikon në jobalancet e OSSH-së.
- ZRRE, duke marrë parasysh efektin e përcaktimit të hershëm të koeficienteve për llogaritjen e humbjeve në shpërndarje, dhe pas kërkesës së OSSH ka analizuar çështjen e ndryshimit të koeficienteve dhe ka parë si të arsyeshme kërkesën e OSSH për ndryshimin e tyre për periudhën e mbetur – deri në fund të vitit 2020.



- Bordi i ZRRE-së, pas prezantimit të argumenteve për arsyeshmërinë e ndryshimit të koeficienteve, ka marrë vendim për aplikimin e koeficienteve të propozuar nga OSSH për llogaritjen e humbjeve në shpërndarje për periudhën korrik – dhjetor 2020, të paraqitur në tabelën e mëposhtme.


| Humbjet në OSSH | korrik | gusht  | shtator | tetor  | nëntor | dhjetor |
|-----------------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|
| Humbjet në %    | 12.91% | 11.37% | 13.52%  | 16.12% | 19.08% | 24.65%  |

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së,

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Selijaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

Vendimi për përcaktimin e koeficienteve për humbje në shpërndarje i dërgohet:

- Të licencuarit KEDS Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.